

RISHPALLJE

Për rekrutimin e stafit infermier, psikolog dhe punonjës social në kuadër të implementimit të projektit “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur”

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri: Bashkia Përmet
Adresa: Sheshi “Abdyl Frashëri”, Përmet
Tel/Fax: +355 813 222 54
E-mail: info@bashkiapërmet.gov.al

Mbështetur në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 15,103, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Ligjit 12/2016 “Për shërbimet e mbrojtjes sociale”, VKM Nr.658 datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 292 datë 15.05.2024, VKB Nr.30 datë 30.04.2024 “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr 97 datë 18.12.2023”, Marëveshje Nr.1022 Prot datë 15.04.2024 midis Programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim UNDP dhe Bashkisë Përmet në zbatim të Programit “Askush të mos mbetet pas”, kërkon të rekrutojë staf për ofrimin e shërbimit të asistencës në shtëpi për të moshuarit si pjesë e zbatimit të projektit si më poshtë:

Nr	Pozicioni	Angazhimi
1	Infermier	3 (160 ditë secili)
2	Psikolog	1 (10 muaj)
3	Punonjës social	1 (2 trajnime)

I. Personat e interesuar, duhet të paraqesin pranë autoritetit kontraktues dokumentacionin e kërkuar si dhe të plotësojnë kriteret si mëposhtë:

1. Kriteret që duhet të plotësojë psikologu janë: (gjithësej 1 Psikolog)

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë diplomën e studimeve të larta, Bachelor dhe master profesional sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë eksperiencë pune
- Te jete pjesë e urdhërit të psikologut

Përshkrimi i punës:

1. Psikologu duhet që të zhvilloj në total 160 seanca për të moshuarit e targetuar në projekt (16 të moshuar) për 10 muaj
2. Psikologu duhet që të jetë i gatshëm dhe ti përgjigjet nevojave të kategorive përfituese me seanca individuale ose ne grup

Dokumentacioni kërkuar:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1- Jetëshkrimi i aplikantit CV;
- 2- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 3- Fotokopje të noterizuar të diplomës
- 4- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore
- 5- Licencën e Ushtrimit të Profesionit
- 6- Certifikime, kualifikime nëse disponohet
- 7- Ofertën për shërbimin

2. Kriteret që duhet të plotësojë infermieri janë: (gjithësej 3 infermier)

- a) Të ketë mbaruar arsimin e lartë për Infermieri.
- b) Të ketë të drejtën e ushtrimit të profesionit
- c) Të ketë eksperiencë pune
- d) Të ushtrojë aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Përmet

Përshkrimi i punës:

- Punon nën drejtimin e Nënkryetarit i cili ka në varësi sektorin e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Përmet dhe personit të kontaktit të projektit i cili mbulohet nga një punonjës i bashkisë si pozicion, për zbatimin me përpikmëri të Projektit “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur”
- Ndjek me vëmendje ecurinë shëndetësore të të moshuarve të targetuar për këtë projekt.
- Kujdeset për ecurinë shëndetësore të të moshuarve, këtë në bashkëpunim të ngushtë me Mjekun e familjes si dhe infermierin e zonës (nëse ka) duke njohur me rigorozitet kartelën e tij mjekësore.
- Njeh dhe zbaton me përpikmëri gjithë fazat e projektit.
- Dokumenton zbatimin e aktiviteteve në kohë dhe i raporton Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki.
- Harton dhe dorëzon në drejtori gjithë procesin e punës së kryer nga ana e tij në lidhje me këtë pozicion.

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale

- 1- Jetëshkrimi i aplikantit CV;
- 2- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 3- Fotokopje të noterizuar të diplomës
- 4- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore

- 5- Licencën e Ushtrimit të Profesionit
- 6- Certifikime, kualifikime nëse disponohet
- 7- Ofertën për shërbimin

3. Kriteret që duhet të plotësojë Punonjësi Social (gjithësej 1 punonjës)

- a) Të ketë mbaruar arsimin e lartë
- b) Punë të ngjashme në ofrim trajnimi mbi tematikat e shërbimeve sociale

Përshkrimi i punës:

- Punon nën drejtimin e Nënkryetarit i cili ka në varësi sektorin e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Përmet dhe personit të kontaktit të projektit i cili mbulohet nga një punonjës i bashkisë si pozicion, për zbatimin me përpikmëri të Projektit “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur”
- Komunikimi i vazhdueshëm me stafin e Bashkisë për ecurinë
- Organizimi i 2 trajnimeve me grupin e interesit dhe ofruesit e shërbimeve
- Informimi dhe këshillimi publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim,
- Këshillimi për shërbimet shëndetësore dhe sociale të mundshme në nivel vendor
- Orientimi i punës së infermierit dhe psikologut për shërbimet e asistencës shtëpiake
- Mbikëqyrja në vazhdim e ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimi mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar;

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale:

- 1- Jetëshkrimi i aplikantit CV;
- 2- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 3- Fotokopje të noterizuar të diplomës
- 4- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore
- 5- Eksperienca të ngjashme
- 6- Certifikime, kualifikime nëse disponohet
- 7- Ofertën për shërbimin

Dokumentacioni duhet të dorëzohet me postë apo drejtpërdrejt në Bashkinë Përmet, brenda datës 06.09.2024.

II. Personat e interesuar mund të kërkojnë informacion për procedurën konkurruese, pranë Bashkisë Përmet,

1. Fondi me TVSH për secilin pozicion është si më poshtë:

Nr	Pozicioni	Fondi limit
1	Infermier 3(tre)	1 269 600 lekë

2	Psikolog 1 (një)	287 500 lekë
3	Punonjës social (një)	42 900 lekë

2. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **dita e premte, datë 06.09.2024, ora 15:00**.
3. Dorëzimi i kërkesave dhe dokumentacionit, bëhet pranë Bashkisë Përmet, Zyra e protokollit
Dokumentat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

**KRYETAR IBASHKISË
Alma HOXHA**